



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 53 regjistër (JR)  
Datë 28.12.2022

Nr. 40 i vendimit  
Datë 15.05.2025

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.05.2025, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 53/2022 (JR), datë 28.12.2022, që i përket:

**ANKUESE:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 565, datë 26.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku).

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës dhe nenet A, Ç, D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë “, të ndryshuar; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; nenet 6, 7, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet në parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku) [në vijim “subjekti i rivlerësimit”], në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ushtronte detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu kontrollin për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
  - (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
  - (iii) ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;
  - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
  - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku), bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe mori vendimin nr. 565, datë 26.09.2022.

#### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 565, datë 26.09.2022, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.* Vendimi i Komisionit është marrë bazuar në nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionin për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 si më poshtë:

*Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin*

*në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, si edhe ka kryer fshehje të pasurisë, duke u vendosur në kushtet parashikuara në germat “b” dhe “c” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

*Gjithashtu, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni vlerësoi në tërësi të gjitha konstatimet e tjera që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, krahas konstatimit të pasurisë së fshehur dhe mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar në tërësi krijimin e pasurive dhe/apo kryerjen e shpenzimeve, arriti në përfundimin se ato janë të tilla që e çojnë këtë trup gjykues në konkluzionin se subjekti, me veprimet e saj, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Pra, vlerësohet gjithashtu se vazhdimi i ushtrimit prej saj të funksionit të gjyqtarës do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për pasojë çon në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se: a) subjekti ka kryer fshehje të pasurisë; b) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

### **III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit**

6. Kundër vendimit të Komisionit nr. 565, datë 26.09.2022, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku), me pretendimin se vendimi nuk është marrë nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe është shkelur parimi kushtetues për garantimin e një procesi të rregullt ligjor e, për rrjedhojë, duhet të konstatohet absolutisht i pavlefshëm nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përfundimisht nga Kolegji: (i) *Riçeljen e hetimit gjyqësor për marrje prove me dëshmitarë për të provuar faktin e përfundimit të punimeve të apartamentit në Gjirokastrë me kontribut shoqëror.* (ii) *Kryerjen e një analize të re financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor.* (iii) *Nëse çmohet se vendimi nr. 565, datë 26.09.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk është nul, pasi të përsërisni hetimin gjyqësor, pas marrjes së provave të reja dhe analizës së re financiare, prishjen e vendimit nr. 565, datë 26.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera dhe konfirmimin tim në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.*
7. Në datën 05.05.2025, pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi pranë Kolegjit një material shkresor të titulluar “Parashtrime”, të pashoqëruar me akte shkresore.

### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

*A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

*a) Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të

vendimeve të dhëna sipas nenit Ë, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Blerta Marku (Çibuku), duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 565, datë 26.09.2022, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
11. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provës me dëshmitarë, trupi gjykues vëren se kërkesa është e paplotë pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar identitetin e dëshmitarëve që kërkon të thirren nga Kolegji dhe, njëkohësisht, nuk plotëson kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, pasi subjekti i rivlerësimit kishte mundësi t’i paraqiste këto prova gjatë zhvillimit të procesit në Komision.
12. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet dokumentacionit të fashikullit të çështjes, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

*B. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale dhe vlerësimi i trupit gjykues*

13. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton procesin e rivlerësimit në Komision si të paragjykuar, haptazi të njëanshëm, të bazuar në një vlerësim të gabuar të provave, me shkelje të rënda procedurale që cenojnë procesin e rregullt ligjor, në drejtim të përbërjes së trupit gjykues dhe arsyetimit të vendimit, duke pretenduar se:
  - i. Është cenuar standardi i vendimmarrjes dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor.
  - ii. Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të hetimit dhe gjykimin nga një trupë gjykuese.

- iii. Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë në procedimin disiplinor për shkak të vlerësimit tim mbi një kriter, duke paragjykuar haptazi vendimin.
- iv. Është cenuar parimi i sigurisë juridike, parimi i barazisë para ligjit, parimi i barazisë së armëve.
- v. Provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe haptazi tendencioze e të njëanshme.

14. Trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit lidhen kryesisht me vlerësimin që Komisioni u ka bërë provave dhe shpjegimeve të subjektit, në mënyrë të ndryshme nga pritshmëria e saj, situatë e cila nuk e bën vendimin të paarsyetuar dhe as të pavlefshëm. Në një vështrim të përgjithshëm të përmbajtjes së vendimit, rezulton se ai plotëson në pikëpamjen formale të gjitha kërkesat e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësim të trupit gjykues, shqyrtimi i këtij shkak është i lidhur me shkaqet e ngritura në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, të cilat janë trajtuar në vijim.
15. Subjekti pretendon në ankim se vendimi i Komisionit dhe i gjithë procesi është absolutisht i pavlefshëm pasi është gjykuar nga një anëtare e trupit gjykues për të cilën ka kërkuar përjashtimin pasi ajo ka qenë në kushtet e konfliktit të hapur të interesit, për shkak se ka pasur të njëjtën situatë për fshehje pasurie dhe, sipas subjektit, i gjithë procesi i saj i rivlerësimit është “korruptuar” për shkak të këtij fakti dhe vendimi i Komisionit është *nul* pasi është cenuar e drejta për një proces të rregullt në drejtim të hetimit dhe gjykimit nga një trupë gjykuese e pavarur dhe e paanshme.
16. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton se, më datë 20.09.2022, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Komisionit me kërkesë për përjashtimin e komisioneres E. Ç. duke pretenduar se, pas njoftimit të datës së seancës, është njohur me vendimmarrjen e GJKKO-së (shkalla e parë) për komisioneren E. Ç., të cilën as nuk e njeh dhe as ka pasur ndonjëherë marrëdhënie, por duke qenë në të njëjtat rrethana ligjore me të, sipas gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit, ajo duhet të kishte dhënë dorëheqjen. Për të mbështetur pretendimet e saj, bashkëlidhur kësaj kërkesë, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vendimin e GJKKO-së nr. {\*\*\*}, datë 16.09.2022, sipas të cilit komisionerja E. Ç. është shpallur e pafajshme në lidhje me veprat penale “Falsifikim i dokumenteve”, si dhe për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurive për personat e zgjedhur dhe nëpunësve publikë”. Në lidhje me sa më sipër, referuar akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues vëren se kërkesa e subjektit për përjashtimin e komisioneres E. Ç., është marrë në shqyrtim nga një trup gjykues i caktuar me short<sup>1</sup>, i cili, me vendimin nr. {\*\*\*} prot., datë 21.09.2022, ka rrëzuar kërkesën e subjektit për përjashtim të komisioneres E. Ç. si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se, në referencë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.09.2022, të GJKKO-së, u vlerësua se pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk qëndrojnë për shkak se procesi penal i zhvilluar nga GJKKO-ja ndaj komisioneres në fjalë, nuk mund të barazohet me procesin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit. Vendimi për rrëzimin e kërkesës i është njoftuar subjektit më datë 21.09.2022. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se Komisioni e ka trajtuar kërkesën për përjashtim

<sup>1</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.09.2022, Komisioni vendosi ngritjen e trupit gjykues me përbërje komisionerët: Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia, Brunilda Bekteshi.

e anëtares së trupit gjykues sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, në garantim të plotë të procesit të rregullt ligjor.

17. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstaton se subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sipas parimit të kontradiktorialitetit, të barazisë së armëve, proporcionalitetit dhe ligjshmërisë. Subjekti i rivlerësimit është pyetur, është njohur me rezultatet e hetimit administrativ dhe aktet e administruara nga hetimi, ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes duke dhënë shpjegime dhe paraqitur prova, si dhe është dëgjuar në seancën dëgjimore.

*C. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi i trupit gjykues*

➤ *Në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 87,93 m<sup>2</sup>, në Gjirokastrë:*

18. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit në lidhje me pasurinë apartament banimi në lagjen “{\*\*\*}”, në Gjirokastrë, se: *trupi gjykues çmon se balanca negative e konstatuar në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, në total në shumën rreth 276.000 lekë, nuk është e mjaftueshme që të passjellë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

19. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ankimit, e ka bazuar në pretendimet se:

19.1. Nga provat e dorëzuara, megjithëse Komisioni u bind se apartamenti ishte blerë në gjendje karabina, sipas tij, shpenzimet e përfundimit të punimeve duhet të ishin aq sa do të na kushtonte apartamenti po ta ndërtonte EKB-ja.

19.2. Ka deklaruar vazhdimisht se nuk ka pasur shpenzime për përfundimin e punimeve pasi ato janë kryer prej bashkëshortit të saj me ndihmën e kolegëve të tij, të cilët i kanë mundësuar atij edhe materialet e ndërtimit. Ndonëse nuk e ka çmuar të nevojshme për t’i kërkuar Komisionit thirrjen e tyre në cilësinë e dëshmitarëve, subjekti kërkon që ata të thirren për të dëshmuar para Kolegjit.

19.3. Komisioni pranon faktin se subjekti nuk kishte detyrim për të deklaruar shpenzimet para vitit 2012, por gjithsesi konkludon se shpenzimet për përfundimin e apartamentit janë mbi 1.000.000 lekë.

19.4. Komisioni, pa u mbështetur në asnjë provë, ka arritur në përfundimin se punimet janë kryer në më pak se tre muaj nga momenti i blerjes së apartamentit karabina, me arsyetimin se personi i lidhur ka nënshkruar një kontratë abonimi të shërbimit të telefonisë fiks dhe, sipas tij, lidhjet për shërbimet e telefonisë bëheshin në pasuri të paluajtshme të përfunduara. Ky deduksion është jo vetëm i pabazuar, por edhe qesharak, për më tepër që Komisioni thotë se punimet mund të kenë përfunduar edhe përgjatë vitit 2004. Konkluzioni i Komisionit, bazuar vetëm në një kontratë pajtimi telefonik, është tërësisht i pabazuar në ligj.

19.5. Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove sipas ligjit, si dhe nuk e ka informuar gjatë hetimit administrativ në lidhje me konkluzionin se shpenzimet e përfundimit të apartamentit janë sipas koston së EKB-së, minus çmimin e blerjes sipas kontratës.

19.6. Konkluzioni i Komisionit për apartamentin në Gjirokastër, nuk përmbush standardin e parashikuar nga ligji e, për pasojë, është i pavlerë.

20. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstatoi si më poshtë.
21. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 87,93 m<sup>2</sup>, i ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër, blerë me kontributin e familjes me vlerë 900.000 lekë, rivlerësuar në vlerën 7.000.000 lekë, pjesa 50%<sup>2</sup>.*
22. Për herë të parë, kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003: *Apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, i ndërtuar pas viteve 1990, vlefte në lekë 900.000 lekë, pjesa takuese 50%, me nr. regjistri hipotekor {\*\*\*}, datë 16.10.2003, nr. pasurie {\*\*\*}. Blerë me kontributin e familjes, vërtetuar me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.08.2003.*
23. Në kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.08.2003, me palë shitëse S. J. dhe palë blerëse Blerta dhe D. M., çmimi i shitjes së pasurisë objekt kontrolli është përcaktuar në shumën 900.000 lekë.
24. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër, ka konfirmuar se në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj figuron e regjistruar pasuria e llojit “apartament banimi” me nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 87,93 m<sup>2</sup>, me adresë: lagjja “{\*\*\*}”, Gjirokastër, regjistruar në bazë të kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.08.2003.
25. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI<sup>3</sup> në lidhje me vlerën e apartamentit dhe burimin e krijimit, subjekti ka sqaruar se: *Vlera është ajo e deklaruar dhe po paraqes kontratën ligjore të blerjes së këtij apartamenti. Burimi i krijimit janë kursimet familjare ndër vite, të ardhura nga emigracioni të bashkëshortit që ka qenë emigrant në shtetin grek.*
26. ILDKPKI-ja, në aktin për kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku), ka konstatuar vlerë të ulët të apartamentit me sipërfaqe 87,93 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 2003, në shumën 900.000 lekë.
27. Gjatë hetimit administrativ, e pyetur nga Komisioni<sup>4</sup> në lidhje me çmimin e caktuar në kontratën e shitblerjes, subjekti ka shpjeguar se: *Unë dhe bashkëshorti, D. M., kemi blerë një apartament banimi nr. {\*\*\*}, zona kadastrale {\*\*\*}, nr. pasurie {\*\*\*}, pasuri kjo e regjistruar në ZVRPP Gjirokastër, sipas vërtetimit hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 26.4.2001 [...]. Sa më sipër, shpjegoj se objekti është blerë karabina, volumet e ndërtimit të saj zënë rreth 35%. Në këtë mënyrë është proceduar edhe me banorë të tjerë të pallatit, sikurse vërtetohet me kontratat e shitjes së sipërcituara. Pra, të gjitha hyrjet e këtij pallati janë blerë në karabina dhe në vlera të përafërta me vlerën e blerë nga ana ime dhe bashkëshortit. [...]. Çmimi i EKB-së bën fjalë*

<sup>2</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur kësaj deklaratë: kontratë shitjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20 gusht 2003, me palë shitëse S. J. dhe palë blerëse Blerta dhe D. M., për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 87,93 m<sup>2</sup>, lagjja “{\*\*\*}”, Gjirokastër, çmimi 900.000 lekë.

<sup>3</sup> Procesverbal i datës 02.02.2015.

<sup>4</sup> Pyetësi nr. 2, përgjigjja e pyetjes nr. 2.

për send të përfunduar e gati për banim, jo për send në fazën e karabinasë. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka depozituar dokumentacionin: i) shkresë e ASHK-së, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, nr. {\*\*\*} prot., datë 26.01.2022; ii) kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.06.2001; iii) kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.05.2001; iv) kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.07.2001; dhe v) aktekspertim nga ing. E. L.<sup>5</sup>.

28. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. D. M., ka lidhur më datë 21.10.2003, kontratë shërbimi me operatorin “{\*\*\*}” ShA për shërbim telefonie për apartamentin e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastrë. Kjo kontratë është lidhur rreth dy muaj pas lidhjes së kontratës për blerjen e apartamentit.
29. Në kushtet kur subjekti nuk deklaroi investimet dhe shpenzimet e kryera mbi këtë pasuri, si dhe në mungesë të situacioneve dhe çdo dokumentacioni tjetër ligjor për kryerjen e punimeve nga gjendja karabina, e pretenduar në momentin e blerjes, në gjendjen përfundimtare të banueshme, Komisioni, bazuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”, i cili përcaktonte se kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 2003, për objekte në qytetin e Gjirokastrës, ishte në vlerën 28.967 lekë/m<sup>2</sup>, konstatoi se, nëse do të merrej për bazë kjo kosto mesatare ndërtimi, vlera e ndërtimit të pasurisë objekt kontrolli, me sipërfaqe totale banimi 87,93 m<sup>2</sup>, do të ishte 2.547.859 lekë<sup>6</sup>, pra më e lartë se vlera e përcaktuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie.
30. Komisioni ka pranuar si çmim të blerjes së kësaj pasurie nga subjekti shumën prej 900.000 lekësh, sipas përcaktimit të bërë në kontratën e shitjes, dhe konsideroi si shpenzime të kryera nga subjekti dhe personi i lidhur mbi këtë pasuri, diferencën mes vlerës së përcaktuar në referim të koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja në vitin 2003 në Gjirokastrë dhe çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, në shumën 1.647.859 lekë.
31. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka qenë e qartë mbi metodologjinë e përlllogaritjes së kostove të ndërtimit nga ana e Komisionit dhe pretendimi se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove se shpenzimet e përfundimit të apartamentit janë përlllogaritur mbi koston e EKB-së, vlerësohet i pambështetur.
32. Kontrata e shërbimit të telefonisë ka shërbyer për Komisionin si *indicie* për përcaktimin e kohës së kryerjes së punimeve për përfundimin e apartamentit, për sa vetë subjekti i rivlerësimit nuk kishte përcaktuar qartë një moment kohor të kryerjes së këtyre punimeve. Ekzistenca e një kontrate të shërbimit të telefonisë në apartamentin e blerë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, jep të dhëna të kohës lidhur me momentin se kur ky apartament ka qenë i banueshëm, pasi pajtimi i shërbimeve të telefonisë fikse lidhet me nevojën për komunikim në banesë, e cila nuk ka logjikë të lidhet nëse ajo nuk është e banueshme dhe kur në të nuk jeton askush. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë e të bazuar qëndrimin e Komisionit

<sup>5</sup> Ekspertja e caktuar nga subjekti i rivlerësimit, ka referuar se në “karabina” futen elementet përbërëse të objektit, të cilat janë themelet, kolonat, trarët, soleta, kafazi i shkallëve dhe muret perimetrale. Karabinaja e objektit zë rreth 35% të koston totale të objektit.

<sup>6</sup> Përlllogaritur sipas koston mesatare të ndërtimit, 28.967 lekë x 87,93 m<sup>2</sup>.

në lidhje me përlogaritjen e vlerës totale të shpenzimeve mbi këtë pasuri dhe të kohës së kryerjes së tyre deri në fund të vitit 2003.

33. Komisioni, në përfundim të analizës së kryer në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, ka arritur në përfundimin se, sa u përket të ardhurave të pretenduara nga puna e bashkëshortit në emigracion do të merren në konsideratë vetëm të ardhurat sipas vërtetimit të datës 05.03.2020, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Arka Unike e të Punësuarve, Sektori i Zyrës së Ndërtimeve, Rafina, Greqi, në referim të të cilit rezulton e provuar se personi i lidhur ka qenë i regjistruar si i punësuar në sektorin e ndërtimit, duke u siguruar në total për 143 ditë kalendarike, për periudhën që u përket viteve 1994 – 1998, në total në shumën prej 144.338 lekësh<sup>7</sup>.
34. Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara sipas vërtetimit të datës 26.01.2022, lëshuar nga kompania konstruktore njëanëtarëshe “{\*\*\*}”, për sa kohë, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka përmbushur detyrimin mbi provueshmërinë e punësimit, të ardhurave të realizuara dhe pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse, si edhe as nuk u provua pamundësia<sup>8</sup> për sigurimin e informacionit apo dokumentacionit përkatës.
35. Në kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të mësipërm, subjekti pretendon se: (i) bashkëshorti ka deklaruar se ka të ardhura nga puna në emigracion 29.000 euro nga viti 1992-2006, por nuk ka deklaruar se në këto vite ka punuar vetëm në emigracion, pasi, pas martesës, ai ka kryer edhe shumë punime hidroizolimi në Gjirokastër, Tepelenë, Sarandë, dhe të ardhurat e përfituara prej tij janë depozituar në bankë në transparencë të plotë; (ii) Komisioni ka përlogaritur vetëm afërsisht 5 muaj punë (143 ditë sigurime në Greqi), ndërkohë që neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligji nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6 të tij kanë parashikuar se duhet të paguhet vetëm tatimi mbi të ardhurat dhe jo kontributi i sigurimeve shoqërore. Bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nenet 4, 8 dhe 10, mbledhja e tatimit mbi të ardhurat parashikohej që të mbahej nga punëdhënësi dhe Komisioni duhet të përcaktojë se cilat detyrime tatimore rëndonin mbi punëmarrësin në shtetin grek nga viti 1992 deri në vitin 2006, kjo pasi, referuar rregullimit ligjor të tatimit mbi të ardhurat edhe në këtë shtet, tatimi mbi të ardhurat e pagës së punëmarrësit dhe sigurimet mbahen dhe derdhen nga punëdhënësi; (iii) për shkak të distancës së largët kohore, e ka të pamundur të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj në emigracion pasi dokumentacioni tatimor në Greqi ruhet për 5 vjet dhe se shuma prej 29.000 eurosh, për 14 vite punë të bashkëshortit të saj në emigracion, është brenda kufijve të arsyes e nuk mund të mos merret në konsideratë, pasi realisht përkojnë me as 2.000 euro në vit; (iv) Komisioni ka mbajtur qëndrim diskriminues ndaj saj, pasi në rastin e një subjekti tjetër<sup>9</sup>, për të ardhurat nga puna në emigracion me vlerë 100.000 euro, e njëjta

---

<sup>7</sup> Komisioni i referohet llogaritjes së të ardhurave të personit të lidhur në Greqi për 143 ditë pune, sipas referencave të viteve 1994-1998, për minimumin jetik: <http://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>.

<sup>8</sup> Megjithëse subjekti ka pretenduar kushtet e pamundësisë në sigurimin e informacionit dhe dokumentacionit justifikues ligjor për të ardhurat e bashkëshortit të saj nga puna në emigracion, nga aktet e çështjes nuk rezulton që të jenë bërë përpjekje në këtë drejtim.

<sup>9</sup> Subjekti i referohet vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, të Komisionit.

relatore e çështjes ka arsyetuar se nga viti 2000 ka kaluar kohë e gjatë, ndërsa sipas së njëjtës relatore, subjekti duhet të kishte bërë më shumë përpjekje për të siguruar dokumentacion provues i cili daton nga viti 1992.

36. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti në emigracion në Greqi dhe puna në Shqipëri, trupi gjykues konstaton si më poshtë.
37. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat nga marrëdhënia e saj e punësimi në gjykatat e rretheve Tepelenë dhe Gjirokastrë, si edhe dokumentacion mbi provueshmërinë e qëndrimit të bashkëshortit të saj në shtetin grek dhe të ardhurat e pretenduara nga puna e kryer prej tij në emigracion<sup>10</sup>. Në këtë deklaratë, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga puna në emigracion gjatë viteve 1992 – 2006, në total në shumën 29.000 euro, ndërkohë që në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 dhe në DIPP-në e vitit 2004, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar të ardhura me burim nga puna e bashkëshortit në emigracion.
38. E pyetur nga Komisioni<sup>11</sup> në lidhje me mosdeklarimin e të ardhurave për bashkëshortin dhe gjendjes *cash* në deklaratën e vitit 2003, subjekti është përgjigjur se: *Me sa kam kuptuar unë në atë kohë kur ka dalë ligji, bashkëshorti nuk ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar. Unë kështu e kam kuptuar ligjin e asaj kohe dhe nuk kam bërë deklaram. Mungesa e një udhëzimi apo orientimi ka sjellë edhe këtë mënyrë interpretimi nga ana ime. Sqaroj se kjo ka ndodhur nga fakti se nuk dija si duhej plotësuar formulari dhe jo me qëllim fshehjen apo shmangien e deklarimit.*
39. Trupi gjykues vëren se, në periudhën shtator 1992-2006, referuar vërtetimit për kohën e sigurimit për punën e kryer në shtetin grek, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, Arka Unike e të Punësuarve, Sektori i Zyrës së Ndërtimeve, Rafina, Greqi, i datës 05.03.2020, për personin e lidhur rezulton të jenë deklaruar të ardhura dhe paguar kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore vetëm për 143 ditë pune për periudhën 1994-1998. Ndërsa, sa i takon vërtetimit të datës 21.06.2022, të kompanisë konstruktore njëanëtarëshe “{\*\*\*}”, trupi gjykues, ashtu sikurse edhe Komisioni, vlerëson se ky vërtetim, i lëshuar nga një kompani private dhe i pashoqëruar me dokumentacion ligjor mbi marrëdhënien e punësimit, si dhe pagesën e detyrimeve tatimore, nuk vërteton burimin e të ardhurave dhe as

---

<sup>10</sup> Në mbështetje të deklaramëve të saj, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, si edhe me përgjigjet e pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, me qëllim provueshmërinë e qëndrimit në shtetin grek të bashkëshortit të saj, si edhe të të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e tij në emigracion, për periudhën 1992 – 1996, subjekti ka depozituar dokumentacion si vijon: i) kartë e regjistrimit të shtetasit të huaj nga policia greke më 23.7.1992; ii) vërtetim i lëshuar nga policia greke më 14.11.2003, për dorëzimin e dokumenteve për nxjerrjen e kartës së posaçme të identitetit dhe shtyrjeve të bëra deri më 16.11.2006; iii) kontratë qiraje e apartamentit të banimit, gjatë qëndrimit në shtetin grek, e datës 01.03.1999; iv) vërtetim për kohën e sigurimit, për punën e kryer në shtetin grek gjatë emigracionit, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Arka Unike e të Punësuarve, Sektori i Zyrës së Ndërtimeve, Rafina, Greqi, i datës 05.3.2020 (ka gjithsej 143 ditë sigurime); dhe v) vërtetim nga kompania konstruktore njëanëtarëshe “{\*\*\*}”, i datës 26.01.2022.

<sup>11</sup> Pyetja nr. 8 e pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

pagesën e detyrimeve tatimore, në mënyrë që këto të ardhura të kualifikohen të ligjshme sipas standardit të vendosur në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

40. Lidhur me pretendimin e subjektit se, lidhur me këto të ardhura, detyrimi për pagimin e tatimit ka qenë i punëdhënësit dhe se nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mosmbajtjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore nga ana e punëdhënësve në Greqi, trupi gjykues vlerëson se, në mungesë të dokumentacionit që provon punësimin dhe të ardhurat e përfituara, ky pretendim i subjektit është i pabazuar dhe vlerësimi i Komisionit në lidhje me të ardhurat nga emigracioni, është në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit në lidhje me trajtimin e të ardhurave nga emigracioni.
41. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin përfundimtar të Komisionit lidhur me pasurinë apartament banimi në Gjirokastër.
- Në lidhje me pasurinë “automjet” i markës “Opel”:
42. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *Automjet i markës “Opel”, me 4+1 vende, me targë {\*\*\*} dhe numër shasie {\*\*\*}, vlera 2.000 euro, burimi i krijimit: kursime nga puna.* Në DIPP-2006, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *Autoveturë 4+1, “Opel”, viti i prodhimit 1998. Blerë nga kursimet e të ardhurave, me targë {\*\*\*}, vlera 2.000 euro.*
43. Në përfundim të kontrollit lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se: *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin në datën 14.8.2006, të pasurisë së llojit “automjet” të markës “Opel”, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
44. Nga analizimi i ankimit dhe parashtrimeve të paraqitura në Kolegj, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur pretendime lidhur me vlerësimin e Komisionit për këtë pasuri dhe, si rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit mbetet i pandryshuar.
- Në lidhje me pasurinë e llojit “likuiditet”, depozitë bankare në BKT, në shumën 21.307 euro:
45. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin në datën 11.03.2011, të pasurisë së llojit “depozitë”, në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, me gjendje në vlerën rreth 21.300 euro, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
46. Në këtë vlerësim, Komisioni ka arritur pasi ka analizuar ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e pasurisë, konkretisht: (i) shumën 10.000 euro të lënë në ruajtje nga babai, para *cash*; dhe (ii) shumën 10.000 euro si kursime *cash* gjendje në datën 31.12.2010.
47. Lidhur me shumën 10.000 euro të pretenduar të lënë në ruajtje nga babai i subjektit disa ditë para vdekjes, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga puna në emigracion e motrave të saj, të cilat pretendohet se kanë shërbyer si burim për dhënien e vlerave monetare në favor të babait të tyre për krijimin e kësaj shume, dhe se shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi lënien e saj në ruajtje,

paraqiten kontradiktore dhe të palogjikshme, për shkak se rezultoi e provuar se nëna e saj kishte hapur llogari depozitë në valutën euro, vetëm rreth gjashtë muaj para depozitimit të shumës 20.000 euro në llogarinë e personit të lidhur dhe, për më tepër, pas rreth shtatë muajsh pasi kishte ndërruar jetë bashkëshorti i saj, z. B. Ç.. Kjo shumë nuk i është nënshtruar pjesëtimit vullnetar në vitin 2014, pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore të babait të subjektit, me depozitimin e saj në llogarinë e personit të lidhur, ajo trajtohet si të kishte qenë pjesë e pasurisë së përbashkët bashkëshortore. Gjithashtu, nuk provohet në mënyrë bindëse se motrat e subjektit kanë pasur dijeni më parë për këtë shumë të pretenduar të lënë në ruajtje apo dhe mbi faktin e deklaruar/konstatuar se ajo disponohet nga bashkëshorti i motrës së tyre. Lidhur me deklarimin nga subjekti të gjendjes *cash* në vitin 2010, Komisioni ka arritur në konkluzionin se ajo ka qenë në shumën 700.000 lekë, e vlerësuar kjo rrethanë në harmoni me deklaratimet e mëparshme dhe vijuese të bëra nga subjekti mbi disponimin e likuiditeteve.

48. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit në lidhje me pasurinë likuiditet, depozitë bankare në BKT, duke ngritur një sërë pretendimesh sa i takon shumës 10.000 euro të lënë në ruajtje babai i të saj, si vijojnë: (i) shuma 10.000 euro i është lënë në ruajtje nga babai i saj dhe kualifikimi i tij si person tjetër i lidhur me të në këtë proces, është në kundërshtim me parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit, trajtimi i babait të saj si person tjetër i lidhur dhe hetimi i pasurisë së prindërve të saj është në tejkalim të ligjit, me pasojë pavlefshmërinë e hetimit dhe konkluzionit të arritur. Tejkalimi i ligjit cenon sigurinë që i jep ligji, pasi, sipas saj, askush nuk do të hetohet sepse hetohet ajo, nëse nuk është i lidhur me të në një marrëdhënie dhurimi, huaje apo huapërdorje; (ii) e ka të paqartë përfundimin e arritur nga Komisioni se nuk provohet dhënia e parave nga motrat e saj, pasi ajo, përtej parashikimeve ligjore, ka provuar të ardhurat e tyre; (iii) Komisioni, jo vetëm keqinterpretonte provat, por, pa prova dhe nëpër rreshta, shprehet se paratë janë të subjektit, pasi bashkëshorti i saj ka përfituar interesat bankarë, ndërkohë që paratë kanë qenë dhe janë në bankë, ndërsa interesat përfitohen për shkak të kontratës së depozitës dhe nuk janë tërhequr prej tyre; (iv) Komisioni nuk e ka trajtuar çështjen e saj sipas jurisprudencës së deritanishme në lidhje me personat e tjerë të lidhur dhe çështja e saj duhet të trajtohet sipas qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. I. B., sipas të cilit, Komisioni nuk duhet të kualifikojë/trajtojë si persona të tjerë të lidhur ata që ligji nuk u jep një status të tillë.
49. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton si më poshtë.
50. Personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, z. D. M., ka deklaruar në deklaratën *vetting*: *Llogari pranë BKT (depozitë me afat 6 muaj), burimi i krijimit: Nga kursimet e akumuluar, nga babai i bashkëshortes pas vdekjes dhe nga interesat bankarë, vlera 21.307,40 euro<sup>12</sup>, pjesa takuese 100%. Subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar: *Të ardhura të lëna në ruajtje nga babai, para cash, 10.000 euro.**

---

<sup>12</sup> Referuar informacionit/dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ për llogaritë e personit të lidhur, rezulton se: i) në datën 11.03.2011, personi i lidhur ka depozituar cash në BKT, vlerën 20.000 euro, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 6-mujor; ii) në datën 02.04.2012, shuma e depozitës së bashku me interesat e përfituar ka qenë në vlerën 20.543 euro, e cila më pas është investuar në depozitë me afat 5-vjeçar dhe rezulton se është maturuar në datën 29.05.2017, në vlerën 21.316 euro.

51. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë konstatohet se:

- i) Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura “cash” nga babai im, pas vdekjes, 10.000 euro.*
- ii) në DIPP-në e vitit 2011, personi i lidhur ka deklaruar: *Depozitë kursimi në BKT, hapur në datën 11.3.2011, vlera 20.000 euro. Burimi: të ardhurat cash nga babai i bashkëshortes pas vdekjes dhe kursimet gjendje në shtëpi, deklaruar deri më 31.12.2010.*
- iii) Në DIPP-në e vitit 2012, personi i lidhur ka deklaruar: *të ardhura nga interesat bankarë mbi shumën e depozituar pranë bankës BKT, dega Gjirokastër, për periudhën 01.01.2012 - 31.12.2012, në shumën 114.336,02 lekë.*
- iv) Në DIPP-në e vitit 2013, personi i lidhur ka deklaruar: *të ardhura nga interesat bankarë mbi shumën e depozituar pranë bankës BKT, dega Gjirokastër, për periudhën 01.01.2013 - 31.12.2013, shuma 370,08 euro dhe 44,79 lekë.*
- v) Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar se: *në numrin e llogarisë bankare pranë bankës BKT, në emër të bashkëshortit D. M., janë përfituar interesat bankarë në shumën 89 euro dhe është mbajtur tatim në burim 10%.*
- vi) Në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur ka deklaruar: *Llogari depozitë pranë BKT (shtim), burimi i krijimit interesat bankarë, shuma 27,31 euro.*

52. Komisioni, kontrollin e kryer në lidhje me pasurinë likuiditet bankar në formën e depozitës në vlerën 20.000 euro pranë bankës BKT, e ka bazuar në analizën e kryer për secilin prej burimeve të deklaruara nga subjekti dhe bashkëshorti i saj për krijimin e kësaj depozite duke vlerësuar se, në referim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, babai i subjektit të rivlerësimit konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe në kuptim të nenit 32, pika 4 e të njëjtit ligj, ajo ka detyrimin të provojë mundësinë financiare të babait të saj për krijimin e shumës 10.000 euro, deklaruar si një nga burimet e pasurisë objekt vlerësimi. Sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *vetting*, provohet se babai i subjektit të rivlerësimit, z. B. Ç., ka përfituar pension pleqërie prej datës 01.04.1993, kurse nëna B. Ç. nga data 01.11.1992.

53. E pyetur nga Komisioni<sup>13</sup> nëse ka në emrin e saj apo nëse është e autorizuar për përdorimin e pasurive/llogarive bankare në emrin e ndonjë personi tjetër në Shqipëri apo jashtë shtetit, subjekti ka deklaruar se: *Në llogarinë e hapur nga bashkëshorti D. M. në BKT, dega Gjirokastër, në vitin 2011, është depozituar edhe shuma 10.000 euro, shumë kjo lënë nga babai im B. Ç. disa ditë para vdekjes. Sqaroj se [...] babai im, në muajin janar të vitit 2010, kaloi në gjendje të rëndë shëndetësore duke u trajtuar në spitalin “{\*\*\*}”, Gjirokastër, për rreth 15 ditë nga {\*\*\*} [...]. Nga biseda që bëra me babain, vendosëm se, në rast se do të duhej të kryente ndërhyrje në {\*\*\*}, ata do ta bënë në spital privat, “{\*\*\*}”. Për këtë, ai më tregoi se kishte hequr mënjane 10.000 euro, siguruar nga kursimet e tij, si dhe lekët që i dërgonin dy vajzat e tjera, motrat e mia që jetojnë në emigracion që nga vitet 1993 njëra dhe që nga viti 1998 tjetra. Çdo muaj, motrat e mia L. Gj. dhe M. M. u dërgonin prindërve sipas mundësive, si një ndihmë për jetën dhe shëndetin e tyre. Këtë shumë ai ma ka dorëzuar mua në Spitalin e Tiranës, duke qenë se isha personi që interesohesha për të dhe ndiqja gjithë procedurat*

---

<sup>13</sup> Pyetësi nr.1, përgjigja e pyetjes nr. 7.

*mjekësore të tij, me qëllim që, në rast nevojë, unë t'i përdorja ato për shëndetin e tij. Në dijëni të këtij fakti, ishte dhe nëna ime B. Ç.. Më datë 01.02.2010, babai im, pasi bëri {\*\*\*}, ndërroi jetë. Nga biseda që kam bërë me mamanë, ajo, duke qenë e vetme në Tepelenë, nuk ishte e sigurt për të mbajtur një shumë të tillë dhe më tha që t'i mbaja unë dhe, në rast nevojë madhore për jetën dhe shëndetin e saj, t'i përdorja. Pra, kjo shumë i përket sot nënës sime B. Ç., por edhe unë për siguri, për mos t'i mbajtur në shtëpi, vendosa t'i depozitoj në bankë dhe, në çdo rast nevojë, t'i tërheq. Që nga dita që babai im ka ndërruar jetë, nëna ime është në kujdesin tim, pasi jam dhe fëmija i vogël në familje.*

54. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar sqarime subjektit për të saktësuar kontributin e secilës prej motrave të saj për krijimin e shumës 10.000 euro nga babai i saj para vdekjes, duke i kërkuar gjithashtu edhe depozitim të dokumentacionit në formën e kërkuar nga ligji. Për sa më sipër, subjekti ka sqaruar se: [...] *Shumën prej 10.000 eurosh, babai im i ndjerë e ka pasur kursime ndër vite nga eurot apo dhrakmitë që dy motrat e mia, L. Gj. dhe M. M., ia sillnin vetë kur ato vinin në Shqipëri ose ia dërgonin me persona të njohur nga qyteti apo dhe të afërmve tanë që jetojnë në Greqi, kur vinin në Shqipëri. Kontributi i secilës, në dijeninë time, ka qenë në mënyrë të barabartë. Motra e madhe L. Gj. iku në emigracion në shtetin grek, familjarisht, në vitin 1992, ku vazhdon të jetë akoma. Po kështu motra tjetër, M. M., iku në emigracion në shtetin grek në vitin 1998, ku vazhdon të jetë akoma<sup>14</sup>.*
55. Në kushtet kur subjekti nuk ka saktësuar kohën dhe vlerat e transferuara nga motrat e saj si ndihmë ndaj prindërve të tyre, të cilat do të konsideroheshin për t'u përfshirë në analizë financiare, Komisioni kreu analizën financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit mbi aftësinë e tyre për të kursyer vlerën 10.000 euro me të ardhurat nga pensionet, sipas së cilës rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi financiare për të kursyer vetëm vlerën 108.580 lekë ose afërsisht 782 euro.
56. Nga hetimi administrativ, Komisioni konstatoi se nëna<sup>15</sup> e subjektit të rivlerësimit, në datën 29.09.2010 ka derdhur *cash* në llogarinë e saj në BKT, vlerën 4.900 euro, të cilat i ka kaluar në depozitë kursimi, çka është konsideruar nga Komisioni si provë se nëna e subjektit, znj. B. Ç., kishte aftësinë që të mbante dhe të administronte vetë shumën 10.000 euro, të pretenduar si të lënë në ruajtje subjektit të rivlerësimit.
57. Trupi gjykues vëren se, ndonëse subjekti ka deklaruar se për krijimin e shumës 10.000 euro si kursim nga babai i saj, kanë shërbyer edhe të ardhurat nga motrat e saj në emigracion, ajo nuk ka qartësuar në asnjë moment shumën e dhëna nga motrat e saj si kontribut për babanë e tyre, ndërsa, në lidhje me kohën e këtyre dhurimeve, ka dhënë shpjegime të përgjithshme se kjo shumë është krijuar ndër vite nga kursimet e babait, si dhe kontributet e dhëna nga motrat e saj sa herë që e kishin të mundur. Ndonëse gjatë hetimit administrativ subjekti ka paraqitur dokumentacion në lidhje me lejen e qëndrimit në Greqi dhe angazhimin me punë të motrave të

<sup>14</sup> Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka depozituar me pyetësin nr. 1, certifikatën e vdekjes së babait, lëshuar nga Gjendja Civile, Bashkia Tepelenë, më datë 13.10.2016, kopje të pasaportave dhe kartave të identitetit të L. dhe L. Gj., si dhe të M. dhe A. M., kopje të deklarimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për A. M. prej vitit 2000 - 2013, kopje të deklarimit të të ardhurave për L. Gj. për vitin 2003- 2004, si edhe çeqet e paguara nga puna e bashkëshortit të saj L. Gj..

<sup>15</sup> Shih shkresën e BKT-së nr. {\*\*\*}, datë 29.12.2020.

saj, ky dokumentacion nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për punësimin e tyre të vazhdueshëm, si dhe sasinë e të ardhurave të realizuara prej tyre. Për njëri nga motrat e subjektit, znj. L. Gj., nuk ka të dhëna të mjaftueshme që të vërtetojnë të ardhurat dhe pagesën e detyrimeve tatimore, ndërkohë që, për motrën tjetër të subjektit, znj. M. M., edhe duke marrë parasysh të dhënat e përfshira në dokumentin “Kopje të deklarimit të të ardhurave dhe shpenzimeve” për periudhën 2000-2013, të ardhurat e evidentuara nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës për dy të rritur në nivelin e varfërisë<sup>16</sup>. Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të bazuar përfundimin e Komisionit se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara nga puna në emigracion të motrave të saj. Nga ana tjetër, sa i takon mundësisë financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e shumës prej 10.000 eurosh deri në fillim të vitit 2010, trupi gjykues e gjeti të drejtë konstatimin e Komisionit se ata nuk kishin burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj shume.

58. Lidhur me “kursime *cash* gjendje deri në datën 31.12.2010”, të deklaruara si burim për krijimin e pasurisë së llojit depozitë objekt shqyrtimi, për të cilat Komisioni ka konkluduar në vendim se: *Lidhur me pretendimet e ngritura mbi mënyrën e deklarimit të likuiditeteve, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se në DIPP-2010, subjekti ka deklaruar gjendje të likuiditeteve në formë cash, rrethanë e cila është vlerësuar në harmoni me deklarimet e mëparshme dhe vijuese të bëra nga subjekti mbi disponimin e likuiditeteve, duke u ndjekur logjika e deklarimit të saj dhe personit të lidhur, trupi gjykues konstaton se:*

i) Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash*, ndërsa në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *Kursimet e krijuara nga të ardhurat nga paga mujore dhe puna private e bashkëshortit, gjendje në shtëpi 500.000 lekë.*

ii) Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *Kursimet e krijuara nga të ardhurat nga paga mujore, shpërblimet, orët shtesë dhe puna private e bashkëshortit, gjendje në shtëpi 600.000 lekë.*

iii) në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *Gjendja në “cash” që janë kursimet e krijuara nga të ardhurat në Raiffeisen Bank deri më 31.12.2010, vlera 700.000 lekë.* Në analizë të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se gjendja *cash* në fund të vitit 2010, ka qenë në shumën 700.000 lekë.

iv) Në deklarimet e likuiditeteve në DIPP-në e vitit 2011, shuma *cash* e deklaruar deri në fund të vitit 2010, është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit si burim për krijimin e depozitës bankare më datë 11.03.2011, ndërsa subjekti ka deklaruar se shuma *cash* për këtë vit, deklarohet 200.000 lekë, me burim kursime nga të ardhurat.

59. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, në lidhje me kursimet *cash* 10.000 euro, deklaruar si burim për krijimin e depozitës objekt shqyrtimi, subjekti ka sqaruar se, në DIPP-në e vitit 2008, ajo ka deklaruar kursime në vlerën 500.000 lekë, dhe në DIPP-në e vitit 2009, ka deklaruar kursime 600.000 lekë, duke pretenduar se këto nuk janë shuma progresive, por shtesa të ndodhura në kursimet *cash* nga viti në vit, të cilat gabimisht i ka deklaruar si “gjendje në shtëpi”, por realisht ka dashur të deklarojë gjendjen progresive prej 1.100.000 lekësh (500.000

---

<sup>16</sup> Përlllogaritur sipas statistikave zyrtare të Eurostat.

lekë + 600.000 lekë), shumë e cila, së bashku me disa kursime të tjera të krijuara prej saj dhe personit të lidhur nga data 01.01.2011 – 13.03.2011, kanë bërë të mundur krijimin e shumës prej 10.000 eurosh. Subjekti gjithashtu ka argumentuar se vlera 700.000 lekë në DIPP-në e vitit 2010, është deklaruar gabimisht prej saj, pasi në fakt kjo ka qenë gjendja e llogarisë në Raiffeisen Bank dhe nuk lidhet me gjendjen *cash* në banesë.

60. Në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur ndonjë pretendim për arsyetimin e Komisionit në vendimin objekt kontrolli, lidhur me kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur deri në fund të vitit 2010.
61. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjeti të drejtë vlerësimin e Komisionit se, lidhur me pasurinë depozitë bankare në BKT, në shumën 21.307 euro, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me pasurinë “apartament banimi” në Tiranë:*

62. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim si të gabuar vlerësimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri<sup>17</sup>, se: *trupi gjykues, mbi bazën e fakteve, rrethanave dhe indicieve të besueshme, krijoi bindjen se në këtë rast, kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, mbajtur/regjistruar në emër të personave të tjerë të lidhur (nënës së saj), me qëllim shmangien e kontrollit të ligjshmërisë së burimeve financiare të krijimit të saj, duke e bërë atë të gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.*
63. Nga përmbajtja e vendimit objekt ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, vlerësimin e tij, e ka mbështetur në konstatimet se: (i) gjatë viteve 2003-2006, subjekti nuk ka deklaruar mbi disponimin e likuiditeteve në gjendje *cash*; (ii) subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar saktësisht shtesat/pakësimet/gjendjet e llogarive bankare për vitet 2004-2007, me gjendje totale në fund të vitit 2006, në shumën rreth 5,5 milionë lekë, pakësimi i të cilave rezulton të ketë shërbyer për likuidimin e pagesës së çmimit të apartamentit në Tiranë; (iii) subjekti nuk ka qenë i qartë dhe koherent në deklaratimet e bëra mbi kontributin e dhënë prej saj dhe personit të lidhur, e konkretisht mbi shumën e të ardhurave të tyre, të cilat kanë shërbyer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, pasi, referuar deklaratimeve në ILDKPKI, në vitin 2015 ka deklaruar se ka kontribuar rreth 2.000.000 lekë, kurse gjatë hetimit administrativ ka vetëdeklaruar se ka kontribuar shumën 44.300 euro me fondet e disponuara në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortit; (iv) mosdeklarimin e transfertave të kryera në vitin 2007, si dhe qëllimin e tyre si përpyetje për shmangien e verifikimit dhe kontrollit të ligjshmërisë së krijimit të likuiditetit bankar; (v) subjekti dhe personi i lidhur kanë rezultuar me balancë negative fondesh për vitet në të cilat janë krijuar likuiditet gjendje në llogaritë bankare gjatë periudhës

---

<sup>17</sup> Nga dokumentacioni që ASHK, Drejtoria Vendore Rurale 1, i ka përcjellë Komisionit, rezulton se në emër të znj. B. Ç., nënës së subjektit, figuron e regjistruar pasuria me nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, z.k {\*\*\*}. Nëpërmjet kontratës së shitjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.10.2012, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. B. Ç., ka blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe të shfrytëzueshme 95 m<sup>2</sup>, në Selitë, Tiranë, me çmim 7.300.000 lekë. Në referim të kësaj kontrate, shitësi ka deklaruar se ka marrë nga blerësjja vlerën e shitjes, me këtë jashtë zyrës noteriale dhe se janë shlyer totalisht midis tyre gjatë fazës së ndërtimit deri në përfundimin e plotë të godinës.

2004 - 2006<sup>18</sup>, pasi subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara si të krijuara për këtë periudhë nga puna e bashkëshortit në emigracion dhe nga puna e tij si hidroizolues në Shqipëri; (vi) nga verifikimi i pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në vitin 2007, bashkëshorti i saj ka depozituar në llogarinë e tij bankare shumat 4.200 euro dhe 900.000 lekë të dhëna nga babai i saj si burim për krijimin e shumave të transferuara në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” SHPK, lidhur me mundësinë financiare të babait të saj për t’i krijuar ato, rezultoi se babai i subjektit nuk kishte të ardhura me burime financiare të ligjshme për t’i justifikuar këto shuma; (vii) vendosja e emrit të bashkëshortit në librezat e shërbimeve utilitare mbi këtë pasuri, si edhe kryerja prej tij e disa pagesave që lidhen me ofrimin e këtyre shërbimeve si të dhëna/fakte/indicie të rëndësishme në kuadrin e verifikimit të situatës faktike; (viii) subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë kontratë porosie apo ndonjë aktmarrëveshje mbi bazën e së cilës të jetë paguar shuma 56.000 euro.

64. Subjekti i rivlerësimit, kundërshtimin e vlerësimit të Komisionit si të gabuar, të palogjikshëm dhe të pabazuar në prova e në fakte e ka bazuar në pretendimet se: (i) Në vitin 2015 është pyetur nga ILDKPKI-ja në lidhje me transferimet bankare nga llogaritë e bashkëshortit, megjithatë nga ana e këtij institucioni nuk është ngritur asnjë pretendim për fshehje pasurie; (ii) Ka kontribuar për prindërit e saj, në kushtet kur edhe ata e kanë ndihmuar gjithë jetën me rritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe mosdeklarimi i pakësimit të pasurisë në vitin 2007, është një gabim nga ana e saj, megjithatë kjo pasaktësi nuk duhet konsideruar e tillë, me pasojë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi të gjitha transfertat janë kryer në mënyrë transparente nëpërmjet bankës, në kohën kur nuk ekzistonte koncepti “burim i ligjshëm” dhe se gjithmonë ka deklaruar se paratë me të cilat është blerë apartamenti nuk kanë qenë të gjitha të sajat; (iii) Komisioni ka bërë analizë financiare të prindërve të saj duke tejkuluar parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi ajo nuk ka deklaruar as hua, as dhuratë nga prindërit e saj apo nga motrat e, për rrjedhojë, ajo nuk mund të mbajë përgjegjësi për paratë që ato u kanë dërguar prindërve dhe as për burimin e tyre; (iv) Komisioni nuk i ka kërkuar të paraqesë prova në lidhje me të ardhurat e dërguara nga motrat e saj për prindërit; (v) Komisioni, duke hetuar mbi dyshime për fshehje, ka vepruar si prokurori, në shkelje të parimeve ligjore, edhe pse është një organ administrativ; (vi) Librezat e energjisë dhe ujit në emrin e bashkëshortit të saj janë bërë nga firma ndërtuese, sipas praktikës së kohës, pasi bashkëshorti i saj nuk ka lidhur kontratë dhe kryerja e pagesave për shërbimet utilitare nuk provon se ata janë pronarë të këtij apartamenti; (vii) Vendimmarrja e Komisionit nuk ndryshon nga rezultati fillestar i përcjellë prej tij dhe konkluzioni për fshehje s’ka as bazë logjike, pasi nga provat e marra, provohet se pronari *de juro* dhe *de facto* i apartamentit është nëna e saj dhe pronësia mbi pasurinë e paluajtshme nuk është gjendje fakti; (viii) Komisioni arsyeton me keqdashje se fshehja në vitin 2007, është bërë që të mos kontrollohej ligjshmëria e burimeve, parashikuar në vitin 2016 me koncept të ri; (ix) Sipas Komisionit, të ardhurat e bashkëshortit në vitin 2007 ishin të ligjshme, ndërsa në vitin 2016 u bënë të paligjshme; (x) Arsyetimi i Komisionit është i pakuptueshëm dhe nuk përmbush standardin e vendimit të arsyetuar.

---

<sup>18</sup> Referuar tabelës përmbledhëse financiare, aneksi 1, pjesë e vendimit të Komisionit.

65. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.
66. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, pjesë e dosjes së hetimit administrativ, Komisioni konstatoi disa transaksione të kryera nga bashkëshorti i subjektit, z. D. M., nga llogaria e tij bankare në Tirana Bank, dhe konkretisht, në datën 15.02.2007 ka transferuar në një llogari tjetër vlerën 31.000 euro, me përshkrimin: *Firma “{\*\*\*}” ShPK, Tiranë, pagesë kësti shtëpie*, dhe në datën 19.04.2007 ka transferuar shumën prej 25.000 euro, me përshkrimin: *“{\*\*\*}” ShPK, lik. kësti shtëpie*.
67. Gjatë hetimit administrativ, e pyetur nga Komisioni<sup>19</sup> nëse ka transferuar ndonjëherë ndonjë shumë të barasvlershme me 500 euro apo më të lartë, në Shqipëri apo jashtë saj, subjekti ka deklaruar se: *për shkak të gjendjes shëndetësore të babait, prindërit e saj shfaqën dëshirën për të jetuar në Tiranë, për arsye se kujdesi shëndetësor është më i mirë dhe për të qenë më afër mjekëve. Për këtë çështje, babai i saj ka dakordësuar me mikun e tij, z. S. J., që kishte firmë ndërtimi në Tiranë, i cili i ofroi një apartament në një nga pallatet që ai po ndërtonte, kundrejt shumës 56.000 euro. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se: Duke qenë se babai nuk kishte një mundësi të tillë financiare, unë dhe bashkëshorti vendosëm të kontribuonim dhe si shenjë respekti për kujdesin që prindërit kanë bërë në rritjen e dy fëmijëve tanë dhe gatishmërinë tonë për të plotësuar dëshirën e tyre.*
68. Në vijim të deklaramit të mësipërm, subjekti ka referuar veprimet bankare të kryera nga personi i lidhur D. M., si më poshtë:
- i.* Në datën 05.02.2007, bashkëshorti D. M. transferon shumën 1.420.235 lekë nga llogaria e depozitës pranë Tirana Bank te llogaria e tij rrjedhëse në këtë bankë.
- ii.* Në datën 05.02.2007, bashkëshorti D. M. derdh në llogarinë e tij rrjedhëse pranë Tirana Bank shumën 4.200 euro, të cilat ia kishte dhënë babai i saj, i ndjeri B. Ç.. Këto para babai i kishte mbledhur nga kontributet e dhëna nga motrat e saj.
- iii.* Në datën 06.02.2007, bashkëshorti D. M. tërheq shumën 940.000 lekë nga llogaria e tij pranë Intesa San Paolo Bank, nga të cilat 900.000 lekë depozitohen te llogaria e tij rrjedhëse pranë Tirana Bank, bashkë me 900.000 lekë të cilat ia kishte dhënë babai i saj, B. Ç.. Këto para babai i kishte mbledhur nga kontributet e dhëna nga motrat e saj.
- iv.* Në datën 15.02.2007, bashkëshorti D. M. tërheq shumën 2.510 USD nga llogaria e tij e kursimeve pranë Tirana Bank.
- v.* Në datën 15.02.2007, bashkëshorti D. M. tërheq nga llogaria e tij rrjedhëse pranë Tirana Bank, shumën 3.200.162 lekë (shumë e cila është krijuar nga transferta 1.420.535 lekë + derdhja 1.800.000 lekë). Këtë shumë, plus shumën prej 2.510 USD, bashkëshorti i saj i ka këmbyer në euro dhe ka kryer derdhje prej 27.460 eurosh te llogaria e tij rrjedhëse në euro pranë kësaj banke.
- vi.* Në datën 15.02.2007, bashkëshorti D. M. kryen një transfertë në shumën 31.000 euro në llogarinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në Tiranë, shoqëria e cila do të shiste apartamentin.

<sup>19</sup> Pyetja nr. 18 e pyetësorit nr. 1 të Komisionit.

vii. Në datën 18.04.2007, bashkëshorti D. M. transferon nga llogaria e tij e depozitës në euro pranë Tirana Bank te llogaria e tij rrjedhëse pranë së njëjtës bankë, shumën 22.184 euro.

viii. Në datën 18.4.2007, subjekti ka tërhequr nga llogaria e pagës pranë Raiffeisen Bank shumën 450.000 lekë, të cilën ia ka dhënë bashkëshortit.

ix. Pasi kryen këmbimin në euro të një pjese të shumës 450.000 lekë, bashkëshorti derdh në llogarinë e tij rrjedhëse në euro pranë Tirana Bank, shumën 2.162 euro.

x. Në datën 19.04.2007, bashkëshorti D. M. kryen një transfertë në shumën 25.000 euro në llogarinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

69. Subjekti ka deklaruar se kontrata e shitjes është finalizuar në vitin 2012, pasi firma e ndërtimit ka bërë me vonesë hipotekimin e objektit. Aktualisht ky apartament është në pronësi të nënës B. Ç..

70. Në shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në datën 02.02.2015 në ILDKPKI mbi pagesat e kryera në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, arsyet e mosdeklarimit të apartamentit, si edhe burimin e krijimit të këtyre shumave të transferuara nga personi i lidhur, subjekti ka deklaruar se: *Apartamenti në Tiranë është porositur nga bashkëshorti në vitin 2007, për llogari të prindërve të mi. Aktualisht apartamenti është i regjistruar në emrin e nënës sime. Për blerjen e këtij apartamenti nga prindërit e mi, kam kontribuar edhe unë, me sa mbaj mend, në shumën rreth 2.000.000 lekë. Në vitin 2007 kam pakësuar gjendjen e llogarisë bankare pranë Tirana Bank, në shumën rreth 8.000 euro, të deklaruar në vitin 2006. Po kështu, kam pakësuar shumën 1.000.000 lekë, pranë Intesa SanPaolo Bank, si dhe rreth 200.000 lekë të pakësuar pranë Raiffeisen Bank, veprime financiare të verifikueshme. Në lidhje me mundësinë financiare të prindërve të saj për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se: *prindërit pa dyshim kanë pasur kursimet e tyre nga puna ndër vite, por, përveç saj, kanë kontribuar edhe dy motrat, të cilat punojnë dhe jetojnë në Greqi qysh para vitit 1996.**

71. Lidhur me pyetjen e Komisionit se përse transfertat e mësipërme për likuidimin e kësteve nuk janë bërë nga llogaritë bankare të babait të saj, i cili kishte llogari bankare aktive në banka të nivelit të dytë në emrin e tij, por u kryen nga ajo e bashkëshortit të saj, subjekti ka shpjeguar<sup>20</sup> se: *këto pagesa janë kryer nga bashkëshorti për shkak të gjendjes shëndetësore dhe moshës së madhe të prindërve të saj, si dhe faktit që nuk ishin të familjarizuar me këto lloj transaksionesh.*

72. Komisioni i ka kërkuar subjektit të sqarojë se mbi cilin akt/dokument (si kontratë porosie, aktmarrëveshje etj.) janë kryer pagesat në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për pasurinë apartament banimi në Tiranë në vitin 2007. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se: *për shkak të marrëdhënies miqësore të babait me administratorin e shoqërisë së ndërtimit, z. S. J., dhe mirëbesimit reciprok që lindte nga kjo marrëdhënie, asnjë nga palët nuk e konsideroi të nevojshëm formalizimin e marrëveshjes me një kontratë me shkrim. Për këtë arsye, të gjitha pagesat janë kryer në bazë të marrëveshjes verbale dhe nuk disponohet asnjë akt i formalizuar<sup>21</sup>.*

<sup>20</sup> Përgjigje e pyetjes nr. 20 të pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

<sup>21</sup> Shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, nëpërmjet informacionit të përcjellë në Komision, ka konfirmuar se z. D. M., nëpërmjet transfertave bankare, ka kryer dy pagesa, një në datën 15.02.2007 në vlerën 31.000 euro dhe pagesa e dytë është

73. Nga verifikimi i kryer mbi llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit, Komisioni konstatoi se përgjatë vitit 2012 e në vijim, nga llogaria e tij bankare në BKT<sup>22</sup>, janë kryer disa pagesa për shërbime utilitare<sup>23</sup> dhe e ka ftuar subjektin të japë sqarime mbi këto pagesa, duke i kërkuar të deklarojë se me cilën pasuri lidhen dhe abonentin në emër të të cilit janë lidhur kontratat e shërbimit. Në përgjigje, subjekti ka konfirmuar se pagesat e kryera për furnizimin me ujë lidhen me kontratën me nr. {\*\*\*} dhe për furnizimin me energji elektrike lidhen me kontratën nr. {\*\*\*}, që i përkasin apartamentit në Tiranë, të regjistruar në emër të nënës së saj, znj. B. Ç.. Në mbështetje të deklarimeve të bëra, subjekti ka depozituar kopje të librezave të energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë, të cilat pasqyrojnë pagesa të kryera për periudhën nga viti 2018 e në vijim.
74. Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA<sup>24</sup>, rezulton se nëna e subjektit, znj. B. Ç., ka kontratë për furnizimin me energji elektrike nr. {\*\*\*}, kodi i klientit {\*\*\*}, hapur në datën 21.07.2009, e lidhur për apartamentin e ndodhur në Selitë, Tiranë. Bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur kësaj përgjigjeje, rezulton se kodi i klientit {\*\*\*} fillimisht i përkiste abonentit D. M. dhe se kontrata është hapur më 21.07.2009, ndërkohë që ndryshimi i abonentit në emër të znj. B. E. Ç., është bërë në vitin 2018<sup>25</sup>. Po ashtu, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, Ujësjellës - Kanalizime Tiranë (UKT) SHA konfirmon<sup>26</sup> se kontrata me nr. {\*\*\*}, për objektin me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, rezulton në emër të nënës së subjektit znj. B. Ç. por, edhe në këtë rast, në referim të dokumentacionit të dërguar nga UKT, kjo kontratë rezulton të jetë hapur fillimisht në emër të personit të lidhur D. M..
75. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se duket se mosdeklarimi i kësaj pasurie është jo thjesht një pasaktësi në deklarime, por fshehje pasurie.
76. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti u ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ të cilat janë të njëjta me ato të ngritura edhe në ankim.
77. Në analizë të situatës faktike si më sipër dhe provave të administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues i vlerëson pretendimet e subjektit të rivlerësimit si më poshtë.
78. Sa i takon pretendimit të subjektit se, në vitin 2015, ka bërë deklarime pranë ILDKPKI-së në lidhje me transfertat bankare nga llogaritë e bashkëshortit në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe se nga ana e ILDKPKI-së nuk është konstatuar fshehje, referuar raportit nr. {\*\*\*}, datë 25.11.2019, të këtij institucioni, në lidhje me kontrollin e plotë të deklaratës *vetting* të subjektit të rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku), në përfundim të kontrollit të ushtruar, rezulton se

---

*kryer në datën 19.04.2007 në shumën 25.000 euro, të cilat konfirmohen edhe sipas të dhënave nga dokumenti “Nxjerrje llogarie”, i kësaj shoqërie.*

<sup>22</sup> Shkresa e BKT-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.12.2020.

<sup>23</sup> Pagesa për kontratën me numër {\*\*\*}, me përshkrimin: “Likuidim ujë”; pagesë për kontratën numër {\*\*\*}, me përshkrimin: “Albtelecom”; dhe pagesë për kontratën numër {\*\*\*}, me përshkrimin: “CEZ”.

<sup>24</sup> Shkresa e OSHEE-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2022.

<sup>25</sup> Referuar dokumenteve të dërguara nga OSHEE: librezë energjie elektrike; certifikatë për vërtetim pronësie dhe praktika shkresore e mbajtur për ndryshimin e abonentit.

<sup>26</sup> Shkresa e UKT-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2022.

ILDKPKI-ja ka konstatuar se *mbeten të paqarta transferimet e bashkëshortit të subjektit të shumës 56.000 euro në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK me përshkrimin pagesë kësti shtëpie, si dhe burimet financiare që kanë shërbyer për këto pagesa*, përfundim i cili evidenton problematikat e konstatuara nga ky institucion në lidhje me pagesat e kryera nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2007.

79. Lidhur me pretendimin e subjektit se mosdeklarimi i pakësimit të pasurisë në vitin 2007 ka qenë një pasaktësi, nga analiza e deklarimeve periodike vjetore të subjektit, trupi gjykues konstaton disa mospërputhje midis deklarimeve të subjektit nga viti 2004 deri në vitin 2007 të likuiditetit gjendje në bankë dhe gjendjes faktike të likuiditetit në llogaritë bankare<sup>27</sup>. Po ashtu, rezulton se për periudhën 2003 – 2006, subjekti nuk ka deklaruar në lidhje me disponimin e likuiditeteve në gjendje *cash*. Subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e likuiditetit bankar në vitin 2007 dhe likuiditeti bankar në shumën 56.000 euro, që ka shërbyer për shlyerjen e kësteve të apartamentit nuk është deklaruar as si e ardhur dhe as si gjendje në llogari bankare apo në *cash*, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Në vlerësimin e trupit gjykues, është i drejtë konstatimi i Komisionit se mosdeklarimi i transfertave bankare për likuidimin e blerjes së apartamentit në shumën 56.000 euro, brenda një periudhe kohore prej rreth 2 muajsh, nuk është një fakt që mund të përbëjë thjesht pasaktësi dhe, si rrjedhojë, pretendimet e subjektit janë jobindëse.
80. Subjekti ka deklaruar një pjesë të likuiditetit bankar të bashkëshortit si të ardhura të përfituara nga puna e tij në emigracion, si dhe nga aktiviteti i tij si hidroizolues në Shqipëri, megjithatë ajo nuk ka paraqitur dokumentacionin justifikues ligjor sa u takon të ardhurave të realizuara nga bashkëshorti i saj për periudhën 2004 deri 2007<sup>28</sup> dhe, si rezultat, nuk provohen burimet financiare të ligjshme të likuiditetit bankar, i cili ka shërbyer për pagimin e çmimit të pasurisë objekti shqyrtimi.
81. Lidhur me pretendimin e subjektit se ajo dhe bashkëshorti kanë kontribuar për blerjen e kësaj pasurie nga prindërit e saj në shenjë mirënjohjeje për përkujdesjen që ata kanë bërë gjithë jetën për rritjen e fëmijëve të tyre dhe se jo e gjithë shuma e transferuar ka qenë e saj, rezulton se subjekti, referuar procesverbalit të ILDKPKI-së, më datë 02.02.2015, ka deklaruar se kontributi

---

<sup>27</sup> Në paragrafët 76 dhe 77 të vendimit, Komisioni ka analizuar gjendjen e llogarive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në disa banka të nivelit të dytë për vitet 2002, 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007, si dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore lidhur me likuiditetet në bankë për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007, për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur pretendime në ankim. Për krijimin e shumës 31.000 euro më datë 15.02.2007, e cila më pas është transferuar për likuidimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit, personi i lidhur ka kryer veprimet: (i) në datën 05.02.2007 – prishur depozita në shumën 1.420.535 lekë, e krijuar në vitin 2004 nga një arkëtim *cash* prej 1.300.000 lekësh, plus interesat e përfituara; (ii) në datën 06.02.2007, z. D. M. ka tërhequr *cash* nga Intesa SanPaolo Bank shumën 940.000 lekë dhe në të njëjtën datë ka depozituar *cash* në llogarinë e tij pranë Tirana Bank, shumën 1.800.000 lekë; (iii) në datën 08.02.2007, është depozituar *cash* nga z. D. M. në llogarinë e tij, shuma 4.200 euro. Për krijimin e shumës 25.000 euro më datë 19.04.2007, e cila më pas është transferuar për likuidimin e këstit të dytë për blerjen e apartamentit, personi i lidhur ka kryer veprimet si vijojnë: (i) në datën 18.04.2007, ka depozituar *cash* 2.162 euro; (ii) ka prishur depozitën pranë Tirana Bank në vlerën 22.184 euro, e cila ka pasur si burim krijimi arkëtimet *cash* gjatë viteve 2004, 2005 dhe 2006 përkatësisht në shumat 8.500 euro, 2.500 euro dhe 10.500 euro.

<sup>28</sup> Për të ardhurat deri në vitin 2003, të cilat janë konsideruar si të përdorura për pasurinë apartament banimi në Gjirokastër, analiza ligjore është bërë në trajtimin e kësaj pasurie më lart në këtë vendim.

i saj konsiston në shumën rreth 2.000.000 lekë dhe se, për këtë, ka pakësuar gjendjen në llogarinë bankare në Tirana Bank në shumën 8.000 euro të deklaruar në vitin 2006, shumën 1.000.000 lekë pranë Intesa SanPaolo Bank, si dhe rreth 200.000 lekë të pakësuar pranë Raiffeisen Bank, ndërkohë që dy pagesat e kryera nga llogaria bankare e bashkëshortit të saj në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, rezultojnë në vlerën 56.000 euro, nga të cilat subjekti i rivlerësimit vetëm për një pjesë prej 11.700 eurosh ka pretenduar se ishin të babait të saj dhe, si rrjedhojë, subjekti ka pranuar se kontributi i saj ka qenë në shumën 44.300 euro, që është shumë më e madhe se shuma 2.000.000 lekë që kishte deklaruar në vitin 2015. Në vlerësim të kësaj situate faktike, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka shpjeguar qartë dhe bindshëm në lidhje me pagesat e kryera nga bashkëshorti i saj për këtë pasuri.

82. Lidhur me pretendimin e subjektit se jo e gjithë shuma e transferuar nga bashkëshorti i saj në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK ka qenë e saj, duke pretenduar se më datë 05.02.2007 dhe 6.02.2007, bashkëshorti i saj ka depozituar shumat 4.200 euro dhe 900.000 lekë në llogarinë e tij rrjedhëse pranë Tirana Bank, të cilat ia kishte dhënë babai i saj, deklaratimet e subjektit në lidhje me burimet e krijimit të këtyre shumave mbetën deklarative, pasi nuk u provuan. Rezulton se prindërit e subjektit përfitonin vetëm të ardhura nga pensioni i pleqërisë në shuma që justifikojnë vetëm përballimin e jetesës dhe nuk justifikojnë krijimin e shumave 4.200 euro dhe 900.000 lekë, po ashtu edhe pretendimi i subjektit se, për krijimin e tyre, kanë kontribuar edhe motrat, ngeli në nivel deklarativ pasi subjekti nuk ka përcaktuar qartë kontributin e secilës prej motrave, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion në formën e kërkuar ligjore, në mbështetje të këtij pretendimi dhe të deklaratave noteriale të motrave të saj të paraqitura me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ<sup>29</sup>.
83. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka bërë analizë financiare të prindërve të saj, në tejkallim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi ajo nuk ka deklaruar as hua, as dhuratë nga prindërit e nga motrat e, për rrjedhojë, ajo nuk mund të mbajë përgjegjësi për paratë që ato u kanë dërguar prindërve dhe as për burimin e tyre, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka qenë shumë i qartë në arsyetimin e vendimit objekt kontrolli se verifikimi i burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit nuk është bërë në bazë të atij parashikimi ligjor, por mbi bazën e dyshimit se pasuria apartament banimi në Tiranë, ishte pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, në përputhje me qëndrimin e mbajtur edhe nga Kolegji në jurisprudencën e tij<sup>30</sup>.
84. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni, duke hetuar mbi dyshime për fshehje, ka vepruar në shkelje të parimeve ligjore, duke mos vepruar si një organ administrativ, por si prokurori, trupi gjykues vlerëson se Kolegji ka qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e tij në lidhje me pretendime të kësaj natyre, ku është elaboruar se kompetenca e Komisionit për të kryer kontrollin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit, është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ në përputhje me parashikimet e Aneksit të

<sup>29</sup> Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.09.2022, deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.09.2022.

<sup>30</sup> Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit sipas vendimeve nr. 15/2019 (JR), nr. 21/2020 (JR) dhe nr. 52/2023 (JR).

Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016<sup>31</sup>, i cili nuk ka asnjë lidhje me procesin penal. Sa më sipër, pretendimi i ngritur nga subjekti, është i pabazuar.

85. Lidhur me pretendimin e subjektit se librezat për pagimin e energjisë dhe ujit në emrin e bashkëshortit të saj kanë qenë të paligjshme, pasi ai nuk ka nënshkruar asnjëherë ndonjë kontratë për shërbimet utilitare dhe se te furnizuesit për lidhjen e kontratës, duhet dorëzuar gjithmonë certifikata e pronësisë, trupi gjykues vëren se, pavarësisht këtij pretendimi, subjekti nuk e kundërshton faktin se bashkëshorti i saj ka bërë pagesa lidhur me këto shërbime.
86. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues i gjen të drejta konstatimet e Komisionit dhe vlerësimin e tij përfundimtar se pasuria apartament banimi me sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>, ndodhur në “Selitë”, Tiranë, është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me vlerësimin e Komisionit për cenimin e besimit të publikut:*

87. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Komisioni, në përfundim të procesit, ka vlerësuar se: *Në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni vlerësoi në tërësi të gjitha konstatimet e tjera që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, krahas konstatimit të pasurisë së fshehur dhe mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar në tërësi krijimin e pasurive dhe/apo kryerjen e shpenzimeve, arriti në përfundimin se ato janë të tilla që e çojnë këtë trup gjykues në konkluzionin se subjekti, me veprimet e saj, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Pra, vlerësohet gjithashtu se vazhdimi i ushtrimit prej saj të funksionit të gjyqtarëve do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për pasojë çon në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*
88. Përveç konkluzionit të mësipërm, Komisioni, pasi ka analizuar veprimet e subjektit të rivlerësimit për lidhjen e një kontrate qiraje për një apartament në Tiranë, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.11.2012, për të cilën, gjatë procesit në Komision, subjekti ka deklaruar se është lidhur formalisht në funksion të aplikimit të saj pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë me qëllim transferimin në Tiranë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit tregojnë një raport të tillë të përkujdesjes së subjektit me zbatimin e ligjit, i cili është i papranueshëm për të pasur besimin e publikut. Rëndësia e sjelljes jashtëgjyqësore të gjyqtarit dhe ndikimi i saj në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare për sjelljen e gjyqtarëve, si Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë<sup>32</sup>, Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore<sup>33</sup> e të tjera akte ndërkombëtare, si*

<sup>31</sup> Kreu VII, “Procedura e rivlerësimit”.

<sup>32</sup> Kodi i Etikës Gjyqësore, i miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në datën 8.12.2006, në rregullën 3 parashikon: “Gjyqtari nuk duhet të lejojë që familja, të afërmit e tij apo persona të tjerë të influencojnë në punën dhe vendimet e tij. Ai nuk duhet të cenojë prestigjin e detyrës gjyqësore për hir të interesave private dhe në të njëjtën kohë nuk duhet t’u krijojë të tjerëve përshtypjen se vepron në mënyrë të tillë”.

<sup>33</sup> Komentari i Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, në paragrafin 108 shpjegon: “[...] Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të

*dhe e jurisprudencës së GjEDNj-së<sup>34</sup>, të cilat theksojnë se shkelja e ligjit nga një gjyqtar jo vetëm dëmton reputacionin e funksionit si gjyqtar, por inkurajon mosrespektimin e ligjit dhe cenon besimin e publikut në integritetin e gjyqësorit.*

89. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në konstatimin se subjekti në DIPP-të e viteve 2012, 2013 dhe 2014, ka deklaruar si *vendqëndrim tjetër*, adresën “Njësia Bashkiake nr. {\*\*\*}, Tiranë”. Komisioni kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila ka informuar se më datë 5.12.2012, subjekti dhe bashkëshorti i saj, z. D. M., kanë ndryshuar vendbanimin nga Bashkia Gjirokastrë, duke u vendosur në Njësine Administrative nr. {\*\*\*}, Tiranë, dhe se, më datë 06.11.2014, ata kanë ndryshuar përsëri vendbanimin duke e rivendosur vendbanimin në Gjirokastrë.
90. Komisioni i ka kërkuar subjektit të sqarojë rrethanat që lidhen me adresën e vendbanimit dhe faktin e nënshkrimit të kontratës së qirasë për apartamentin në Tiranë. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka sqaruar se kontrata nuk është deklaruar prej saj në deklaratat periodike vjetore, pasi ajo ka qenë formale dhe nuk ka prodhuar asnjë efekt, realisht as kanë paguar qira dhe as kanë banuar ndonjëherë në atë adresë. Arsyeja e hartimit të kësaj kontrate, sipas saj, ishte një kërkesë e bërë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për transferim me detyrë në Gjykatën e Tiranës dhe se kjo kontratë kishte shërbyer si provë vendbanimi në Tiranë, kusht pa të cilin transferimi i mundshëm me detyrë në Gjykatën e Rrethit Tiranë, nuk mund të realizohej. Formalisht ka qenë banore e Tiranës deri në vitin 2014, ndërsa faktikisht ka vijuar jetesën dhe punën në qytetin e Gjirokastrës.
91. Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se subjekti, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së qirasë, ka kryer veprime fiktive me qëllim përfitimin e promovimit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në seancën dëgjimore të zhvilluar për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit e ka pyetur ankuesen se përse u lidh kjo kontratë me shtetasin D. A., ndërkohë që nëna e saj posedonte apartament banimi në qytetin e Tiranës. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se nëna mund të donte ta jepte me qira, të rrinte e vetme apo me nipin dhe mbesën dhe nuk mund të qëndronin shumë persona në të njëjtën shtëpi.
92. Sipas Komisionit, subjekti ka pranuar kryerjen e veprimeve simuluese për lidhjen e kontratës së qirasë dhe, si rrjedhojë, ka pranuar edhe deklarimin e rrethanave të rreme në formularët e ILDKPKI-së për vitet 2012 – 2014, mbi vendqëndrimin e saj, adresën tjetër të banimit. Po ashtu, Komisioni ka vlerësuar se lidhja e kontratës së qirasë me një person tjetër, në kushtet kur nëna e saj dispononte apartament banimi në Tiranë, tregon edhe një herë se subjekti ka dashur të shmangë lidhjet e saj me këtë pasuri dhe mundësinë e verifikimit të ligjshmërisë së burimeve financiare për krijimin e saj, fakt i cili është konsideruar nga Komisioni si element që përforcon bindjen se ky apartament është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

---

*të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitetin dhe të dëmtojë imazhin e gjyqtarit e të ngrejë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit në tërësi.”*

<sup>34</sup> GjEDNj-ja, në çështjen *Baka k. Hungarisë (Dhoma e Madhe 2016)*, është shprehur: “Gjykata në shumë raste ka theksuar rolin e veçantë të gjyqësorit, i cili, si një garantues i drejtësisë, njëherë nga vlerat themelore të shtetit të së drejtës, duhet të gëzojë besimin e publikut që të jetë i suksesshëm në kryerjen e detyrës së tij”.

93. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim konkluzionin e mësipërm, duke pretenduar se, referuar Komentarin të Parimeve të Bangalores, të cituar nga Komisioni në vendim, cenimi i besimit të publikut ka të bëjë me punën e saj si gjyqtare, ndërkohë që Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim se si është cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë përkundër pavarësisë së gjykatës, integritetit të saj, paanshmërisë dhe efikasitetit në proceset gjyqësore. Sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, është tërësisht i paarsyetuar dhe duhet të ndryshohet prej Kolegjit.
94. Në vlerësim të sa më sipër, në lidhje me deklarin e adresave, nga verifikimi i deklaratave periodike, trupi gjykues vëren se në DIPP-të e viteve 2012-2013, subjekti ka deklaruar adresën e regjistrimit në gjendjen civile “Njësia Bashkiake nr. {\*\*\*}, Tiranë”. Ky deklarin i subjektit përputhet me të dhënat e sakta të regjistrimit në gjendjen civile<sup>35</sup>. Njëkohësisht, me adresën e regjistrimit në gjendjen civile, rezulton se subjekti ka deklaruar edhe vendqëndrim tjetër, adresën e plotë të banimit në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër, duke përbushur kështu edhe detyrimin për deklarin në përputhje me kërkesat e formularit, si dhe me situatën faktike të regjistrimit të saj në atë kohë. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se konstatimi i Komisionit për deklarin të rremë në formularët e ILDKPKI-së është i pabazuar.
95. Lidhur me kontratën e qirasë, e cila, sipas shpjegimeve të vetë subjektit, është lidhur në mënyrë fiktive me qëllim përbushjen e kriterëve për transferimin në detyrë në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se, nën dritën e Parimeve të Bangalores, sjellja e subjektit me nënshkrimin e një kontrate fiktive për qëllime që lidhen me ecurinë në karrierë, cenon integritetin që një gjyqtar duhet të dëshmojë përkundërt një vëzhguesi të arsyeshëm. Pavarësisht këtij vlerësimi, i cili konfirmon qëndrimin e Komisionit, trupi gjykues vlerëson se ky konkluzion i cili lidhet me sjelljen jashtëgjyqësore të subjektit, mund të trajtohet në lidhje me etikën e magjistratit në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe jo në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë. Në kushtet kur procesi i rivlerësimit të subjektit është bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se problematika e mësipërme nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
96. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se, si elemente të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë duhet të konsiderohen edhe konstatimi për pasurinë e fshehur dhe mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar në tërësi krijimin e pasurive dhe/apo kryerjen e shpenzimeve, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur këto situata faktike janë kualifikuar nga Komisioni sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84.2016, kualifikimi edhe sipas nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj është i panevojshëm.

➤ *Në lidhje me analizën financiare:*

97. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit mbi të cilën ai ka bazuar konkluzionin se: *subjekti paraqitet me një balancë negative fondesh, në total në vlerën rreth 11 milionë lekë, nga ku Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe*

<sup>35</sup> Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga kjo drejtori, rezulton se këta shtetas janë regjistruar si banorë të kësaj njësie, bazuar në kontratën e qirasë së datës 23.11.2012, në referim të së cilës subjekti i rivlerësimit ka marrë me qira nga shtetasi D. A., një apartament në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 20.000 lekë në muaj, me afat kohor 1 vit, me të drejtë ripërtëritjeje.

*personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003, si edhe për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2010, 2011, 2014, 2015, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

98. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar këtë shkak ankimi në argumentin se nëse disa zëra të analizës financiare të Komisionit do të rillogariten sipas pretendimeve të saj, kjo analizë rezulton me balancë negative, në total (-) 1.620.798 lekë, ndërkohë që duke konsideruar në mënyrë progresive balancat pozitive ndër vite, analiza financiare rezulton në vlerë pozitive në shumën 3.443.367 lekë. Pretendimet e subjektit u analizuan nga trupi gjykues mbi bazën e akteve të fashikullit të Komisionit si më poshtë.
99. Në lidhje me pretendimin e subjektit se te zëri “Shtesa/pakësime likuiditete”, për vitin 2004, është ngarkuar padrejtësisht me shumën 742.544 lekë, nga kontrolli i ushtruar analizës së kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se për vitin 2004, ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë është konsideruar me të drejtë 3.134.404 lekë, pasi gjendja e llogarive bankare në fund të vitit 2004, rezulton të jetë 3.134.404 lekë, ndërsa në fund të vitit 2003 ka qenë zero, përkundër sa pretendon subjekti se në fund të viti 2003, likuiditeti në bankë ka qenë 742.544 lekë. Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve është përlllogaritur si diferencë e gjendjes së vitit objekt analize me gjendjen e vitit paraardhës e, për rrjedhojë, për vitin 2004 përlllogaritjet e kryera nga Komisioni janë të sakta.
100. Lidhur me pretendimin se te zëri “Shpenzime/pagesat e kryera nga bashkëshorti për blerje materialesh hidroizoluese në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për vitin 2006”, Komisioni rëndon padrejtësisht analizën financiare me shumën 1.764.200 lekë, pasi kjo shumë ka të bëjë me pagesa të kryera nga bashkëshorti i saj për blerjen e materialeve për llogari të klientëve të tij që lidhen me punën si hidroizolues, trupi gjykues konstaton se:
- 100.1. Nga dokumentacioni i Intesa Sanpaolo Bank<sup>36</sup>, rezulton se gjatë vitit 2006, bashkëshorti i subjektit ka kryer dy transferta në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, konkretisht: në datën 25.07.2006, është transferuar shuma 686.250 lekë pa përshkrim; në datën 22.09.2006, është transferuar shuma 548.500 lekë me përshkrimin “Likuidim faturash”. Po ashtu, rezulton të jetë kryer edhe një transfertë në shumën 1.019.500 lekë, më përshkrimin: “Likuidim fature, dt. 16.01.2006, nr. {\*\*\*}”, ku nuk është e mundur të identifikohet përfituesi.
- 100.2. Referuar analizës paraprake financiare, rezulton se Komisioni e ka ngarkuar subjektin me shpenzime në shumën 2.290.250 lekë, duke i konsideruar transfertat bankare të përshkuara më sipër si shpenzime të subjektit, ndërkohë që, në tabelën e analizës financiare përfundimtare në vendim, shuma e ngarkuar si shpenzim rezulton të jetë 1.764.200 lekë, ndryshim i cili nuk shoqërohet me arsyetim në lidhje me shkaqet që kanë çuar në këtë konkluzion.
101. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se këto transferta kanë të bëjnë me blerje materialesh hidroizoluese për llogari të klientëve të bashkëshortit dhe se materialet nuk janë përdorur për nevoja të tyre. Nga provat e administruara, një fakt i tillë mbetet i paprovuar, pasi

<sup>36</sup> Shkresa kthim përgjigjeje e Intesa Sanpaolo Bank nr. {\*\*\*} prot., datë 14.12.2020.

ka shumë pak të dhëna lidhur me aktivitetin që bashkëshorti i subjektit pretendohet se ka kryer si hidroizolues, apo në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e këtij të fundit nga ky aktivitet. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, referuar përshkrimin të këtyre transfertave, duket se bashkëshorti i subjektit ka bërë likuidim faturash në drejtim të “{\*\*\*}” ShPK, shoqëri që ka objekt aktiviteti tregtimin e materialeve hidroizoluese dhe kimikateve për ndërtim, etj., në dukje afër aktivitetit të deklaruar nga subjekti për bashkëshortin e saj. Marrëdhënia e bashkëshortit të subjektit me këtë shoqëri është konfirmuar edhe nëpërmjet shkresës me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.03.2022, “Kthim përgjigje”, të kësaj shoqërie për Komisionin, ku administratori i saj, z. R. Ç., ka deklaruar se z. D. M. ka qenë klient i tyre para shumë vitesh, për blerjen e materialeve të ndërtimit dhe hidroizoluese, megjithatë, për shkak të tejkalimit të afatit 10-vjeçar, nuk është ruajtur dokumentacion tatimor në lidhje me blerjet e kryera pre tij. Sa më sipër, duket e besueshme se bashkëshorti i subjektit ka bërë furnizime pranë kësaj shoqërie për qëllime të punës së tij dhe transfertat bankare për likuidim faturash mund të jenë kryer për llogari të klientëve, të cilat nuk duhet t’i ngarkohen subjektit dhe duhet të zbriten nga analiza financiare e vitit 2006. Nga rishikimi i analizës financiare të Komisionit, duke zbritur shpenzimin prej 1.764.200 lekësh, sipas pretendimit të subjektit, trupi gjykues konstaton se balanca negative e vitit 2006 mbetet në shumën (-) 1.659.860 lekë.

102. Lidhur me pretendimin e subjektit se, te zëri “Shpenzime për përshtatjen e banesës karabina, apartamenti në Gjirokastrë, për periudhën 1995-2003”, ku rezulton të jetë përfshirë shuma prej 1.647.859 lekësh, rëndimi i analizës financiare me këtë shumë është totalisht i paligjshëm dhe i pambështetur me dokumentacion, trupi gjykues vlerëson se, sikurse trajtuar më sipër në këtë vendim në kuadër të analizimit të pasurisë apartament banimi në Gjirokastrë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur.
103. Në lidhje me pretendimin e subjektit se duhet të rianalizohet qëndrimi i mbajtur nga Komisioni në paragrafin 40 të vendimit, pasi është tepër konfuz dhe nuk qartëson se cilat të ardhura janë përlllogaritur në vitin 2006, nga verifikimi i kryer, trupi gjykues vëren se subjekti i referohet një gabimi material të kryer nga Komisioni në paragrafin nr. 40, pika ii e vendimit të Komisionit, ku në përlllogaritjen e të ardhurave nga paga e subjektit për periudhën 1995 – 2003, Komisioni gabimisht i referohet vitit 2006 në vend të vitit 1996. Ndërsa në lidhje me të ardhurat për vitin 2006, nga kontrolli i ushtruar nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka përlllogaritur të ardhurat nga paga e subjektit në shumën 837.333 lekë.
104. Në lidhje me pretendimin e subjektit se, te zëri “Të ardhura nga puna e bashkëshortit në emigracion”, Komisioni, në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim të hapur me qëndrimin e mbajtur në çështje të tjera<sup>37</sup>, nuk pranon njohjen e kursimeve të deklaruara nga subjekti dhe sqarimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues, sikurse analizuar edhe më lart në këtë vendim, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor që provon të ardhurat e bashkëshortit ndër vite, të pretenduara nga puna në emigracion, në përputhje me standardin e vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe pretendimi i saj për njohjen e të ardhurave në shumën 29.000 euro, mbetet deklarativ.

---

<sup>37</sup> Subjekti i rivlerësimit i referohet vendimit nr. 479, datë 3.12.2021, për subjektin e rivlerësimit A. D..

105. Lidhur me pretendimin e subjektit se, te zëri “Të ardhura nga puna e bashkëshortit gjatë viteve 2007-2016”, duhet të përfshihet shuma 2.780.000 lekë, si të ardhura të përfituara nga bashkëshorti i saj nga puna si hidroizolues në Shqipëri, trupi gjykues vëren se, referuar dokumentacionit të paraqitur prej saj, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni prej institucioneve tatimore<sup>38</sup>, bashkëshorti i subjektit nuk figuron i regjistruar pranë organit tatimor as si punonjës dhe as si i vetëpunësuar. Po ashtu, referuar shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 03.02.2022, të ISSH Drejtoria Rajonale Gjirokastër, për z. D. M., të dhënat për pagesë të kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore, rezultojnë vetëm për vitin 2021 dhe nuk ka të dhëna për vitet e mëparshme në lidhje me të<sup>39</sup>. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor që provon të ardhurat e bashkëshortit ndër vite nga puna e tij si hidroizolues në Shqipëri, në përputhje me standardin e vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
106. Në lidhje me pretendimin e subjektit se, te zëri “Të ardhura nga babai, para *cash* 10.000 euro në ruajtje”, duhet të shtohet si e ardhur shuma 10.000 euro, konvertuar në 1.383.000 lekë, trupi gjykues, sikurse trajtuar më sipër në këtë vendim, vlerëson se pretendimi i subjektit se kjo shumë i ishte lënë në ruajtje nga babai i saj, u vlerësua deklarativ e jobindës dhe, për këtë arsye, shuma e pretenduar prej 10.000 eurosh ose 1.383.000 lekësh nuk duhet të përfshihet si e ardhur në vitin 2010.
107. Në lidhje me pretendimin se, te zëri “Të ardhura nga babai i subjektit të rivlerësimit sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore, datë 15.09.2014”, nuk është përfshirë asnjë shumë, megjithëse është e qartë se subjekti ka përfituar shumën 74.660 lekë si pjesë takuese nga çelja e dëshmisë së trashëgimisë së babait të saj, nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues vëren se, ndonëse dëshmia e trashëgimisë së babait të subjektit të rivlerësimit është çelur në vitin 2014, referuar dokumentacionit bankar, rezulton se pjesa takuese e subjektit është tërhequr nga llogaria e tij bankare në vitin 2018 dhe, për këtë arsye, të ardhurat nga trashëgimia nuk rezulton të kenë qenë në dispozicion të subjektit në vitin 2014.
108. Në lidhje me pretendimin e subjektit se, te zëri “Të ardhura nga shumat e dhëna nga babai i ndjerë i subjektit për blerjen e apartamentit në Tiranë”, duhet të përfshihen shumat që motrat e subjektit i kishin dhënë atij, në vlerat 900.000 lekë dhe 4.200 euro, trupi gjykues vlerëson se, sikurse analizuar më lart në këtë vendim, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me të ardhurat e dërguara nga motrat e subjektit, mbeti deklarativ dhe i paprovuar.
109. Në konkluzion të vlerësimit të pretendimeve të subjektit lidhur me disa zëra të analizës financiare të Komisionit si më sipër analizuar, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të deklaruara dhe të konstatuara për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003, si dhe për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2010, 2011, 2014 dhe 2015, në vlerën totale prej (-) 9.253.125 lekësh, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>38</sup> Shkresa e DPT-së nr. {\*\*\*} prot., datë 18.12.2020, shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2020.

<sup>39</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2020.

110. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhojë, vendimi i Komisionit është i mbështetur në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 565, datë 26.09.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku).
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.05.2025.

**ANËTARE**

**ANËTARE**

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**Mimoza Tasi**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**KRYESUESE**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*